



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR MARRËDHËNIET E
AVOKATURËS SË SHTETIT DHE PERSONAVE JURIDIKË NË
KUADËR TË OFRIMIT TË ASISTENCËS JURIDIKE, ROLIN E
AVOKATËVE TË SHTETIT NË GJYKIM, SI DHE NORMA TË
POSAÇME PROCEDURALE

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 7, 5 pika 1, 12, pikat 2 e 6 të ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullores, “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit dhe personave juridikë në kuadër të ofrimit të asistencës juridike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Vendimi nr.392, datë 8.4.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale””, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA